



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING

Nr. Prot. 1089-2/26
Broj. Prot. 1089-2/26
Data 03.09.2026
Datum 03.09.2026

Nr. i faqeve -09-
Broj. stranica
No. pages

PRISTINE/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	01.09.2026
REFERENC-Ë:	26/1084/MMPH 26/1679/MMPH 26/1678/MMPH
PËR/ZA/TO:	"Mendi- P" SH.P.K. Kramovik- Rahovec Seperacion dhe fabrikë e betonit në Kramovikë- Rahovec.
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka kontrolluar kërkesën për Leje Mjedisore, me nr. prot. 26/1084/MMPH, dt.: 09.03.2026, kërkesën me nr. prot. 26/1679/MMPH, dt. 03.04.2026, si dhe 26/1678/MMPH të dt. 03.04.2026, të parashtruar nga operatori "Mendi- P" SH.P.K. Kramovik- Rahovec, për veprimtaritë: seperim te inerteve dhe fabrikë e betonit në Kramovikë- Rahovec.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe një sërë takimesh, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni:

1. Vendimi për ndërprerje të procedurës administrative të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin "Mendi- P" SH.P.K. Kramovik- Rahovec, për veprimtaritë: seperim te inerteve dhe fabrikë e betonit në Kramovikë- Rahovec.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the
General Secretary

Nr. 26/1084/MMPH
Nr. 26/1679/MMPH
Nr. 26/1678/MMPH
Datë: 01.09.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 10, paragrafit 3 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI- Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit "Mendi-P" SH.P.K. Kramovik- Rahovec, i ndërpritet procedura administrative për kërkesat: me nr. prot. 26/1084/MMPH, dt.: 09.03.2026, me nr. prot. 26/1679/MMPH, dt. 03.04.2026, si dhe nr. prot. 26/1678/MMPH të dt: 03.04.2026, për vazhdimin e Lejes Mjedisore me nr. prot. 18/6285/ZSP/177/19, të lëshuar me dt. 12.04.2019, e korrigjuar me 16.10.2026, për veprimtaritë: seperim të inerteve në ngastrën kadastrale me nr. 372, zona kadastrale Kramovik Rahovec, sipas Vendimit për Pëlqim Mjedisor për seperim të inerteve me nr. 06/2187/1-ZSP-4/11, të lëshuar me dt. 20.01.2011, si dhe për bazën e betonit në ngastrat kadastrale nr. P-71510039- 00373-0 dhe nr. P-71510039- 00374-0, zona kadastrale Kramovik- Rahovec, sipas Pëlqimit Mjedisor me nr. 1263-2/18, të lëshuar me dt. 31.05.2018.

Arsyetim

Pas pranimit të kërkesave për Leje Mjedisore me nr. prot. 26/1084/MMPH, dt.: 09.03.2026, me nr. prot. 26/1679/MMPH, dt. 03.04.2026, si dhe nr. prot. 26/1678/MMPH të dt: 03.04.2026, për vazhdimin e Lejes Mjedisore me nr. prot. 18/6285/ZSP/177/19, të lëshuar me dt. 12.04.2019, e korrigjuar me 16.10.2026, për veprimtaritë: seperim të inerteve në ngastrën kadastrale me nr. 372, zona kadastrale Kramovik Rahovec, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore ka kontrolluar lëndën administrativisht dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve me datë 11.03.2026, si në vijim:

- Kërkesat dhe aplikacionet duhet të jenë të ndara për dy veprimtaritë (Një kërkesë dhe aplikacion për seperacion të Inerteve dhe një kërkesë dhe aplikacion tjetër për bazën e betonit);
- Lejen për aktivitete të veçanta për seperacion të Inerteve dhe po ashtu për bazën e betonit;
- Lejen Ujore për Shfrytëzim dhe Lejen Ujore për Shkarkim për seperacion të Inerteve dhe po ashtu për bazën e betonit;
- Në formularin e kërkesës për vazhdimin e Lejes Mjedisore nuk keni deklaruar vlerën financiare të investimit të projektit (euro), nënshkruar nga personi përgjegjës i kompanisë (Duhet ta deklaroni ndaras për dy kërkesat).

Operatori me datë 03.04.2026 ka paraqitur dy kërkesa ndaras aplikimet për bazën e betonit kërkesa me nr. prot. 1678/26, dt. 03.04.2026, si dhe kërkesa për sepërim te inertiaeve me nr. 1679/26, dt. 03.04.2026.

Me dt. 04.05.2026, operatori ka sjell informata shtesë përmes arkivit te MMPH-së si ne vijim:

- Leje për Aktivitete të Veçanta për sortues nga KPMM me nr. KPMM/969/2025, Nr.Prot.4317, dt.19.12.2025 me afat te vlefshmërisë 25.07.2028;
- Leje për Aktivitete të Veçanta për betonierë nga KPMM me nr. KPMM/979/2026, Nr.Prot.412, dt.19.02.2026 me afat te vlefshmërisë 26.08.2028;
- Flet aplikimet për Leje Ujore.

Për kërkesat e lartcekura operatori ka sjellë pjesërisht informata shtesë.

Si përfundim mungon:

Leja Ujore për shfrytëzim të ujit;

Leja ujore për shkarkim te ujit.

Operatori nuk ka sjellur dëshmi ne përputhje me kërkesën e komisionit të dt. 08.04.2026.



Komisioni për Leje Mjedisore ne takimin e mbajtur me datë 01.09.2026, konstatoi se operatori "Mendi- P" SH.P.K. Kramovik- Rahovec, për veprimtaritë: seperim te inerteve dhe fabrikë e betonit në Kramovikë- Rahovec, nuk i plotëson kriteret e parapara për fillimin e shqyrtimit të kërkesës për vazhdim të Lejes Mjedisore, pasi qe nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur me lartë në afatin kohorë të përcaktuar nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbyll procedurën administrative në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.


Bajram Kafexholli
U.D i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës;
- DMM-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së.